

20141012904

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 1

Në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14 dhe 44/14), në nenin 92 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

„Radiodifuzerët televizivë me format të përgjithshëm obligohen gjatë javës të emitojnë së paku tetë orë, kurse servisi publik radiodifuziv së paku 14 orë, muzikë instrumentale të autorëve maqedonas dhe autorëve të bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, nga e cila 50% duhet të jetë muzikë argëtuese instrumentale, vokale dhe/ose instrumentale vokale, kurse 50% muzikë popullore instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale, me ç’rast lejohet shmangie prej 5% në raport me ndarjen e emitimit të muzikës argëtuese dhe popullore instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale."

Në paragrafët (5) dhe (13) pas fjalës "emituar" shtohet fjala "instrumentale,".

Neni 2

Në nenin 117 paragrafi (1) alineja 4 ndryshohet si vijon:

"Dy shoqatat e gazetarëve nga Republika e Maqedonisë me numër më të madh të anëtarëve propozojnë nga një anëtar,".

Neni 3

Në nenin 136 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i (4) si vijon:

„(4) Ekonomia familjare shtëpiake që është pranuese e ndihmës sociale me para dhe ndihmës së përhershme me para, në pajtim me ligjin, është e liruar nga pagimi i taksës radiodifuzive."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".